



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izbornii Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.694/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, Fatmir Rudari nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 09.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës, Fatmir Rudari nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë,

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Podujevë, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë dega në Podujevë, në Vendvotimet: 1809E/01R, 1812E/03R dhe 1837E/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 09.11.2017, nga Fatmir Rudari kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e PDK-së, me të cilën pretendon se e ka votuar familjarët e tij por votat mungojnë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimet e cekura më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 694/2017 më datën 10.11.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Gjytnere Sylejmani**



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.